



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me pajisje për ruajtjen e qumështit

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës që posedojnë gjedhe qumështore, që të aplikojnë për pajisje për ruajtjen e qumështit - Laktofrizë 500 litra.

Kriteret e përcaktuara:

- Të ketë 10 deri 25 krerë gjedhe qumështore;
- Gjedhet qumështore duhet të jenë të matrikuluara;
- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve qumështore kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve qumështore;
- Përparësi do të kenë fermerët të cilët nuk kanë përfituar në 3(tri) vitet e fundit pajisje për ruajtjen e qumështit - Laktofrizë nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Përparësi do të kenë fermerët të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale për shitjen e qumështi me qumështoret;
- Në kushte të barabarta, përparësi do të kenë fermerët në zonat e thella malore;
- Të jetë banor i komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) të ndodhet në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Kontratë marrëveshje me pikën grumbulluese të qumështit (qumështores);
- Pasqyra financiare për pagesën e qumështit nga ana e qumështores në 3 muajt e fundit;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë.

Data e aplikimit nga : 22.07.2019 deri më 09.08.2019